

LAJME / KRONIKA E ZEZË

Hajnat vjedhin arsenal armësh në shtëpinë e ferizajasit



Foto: Ilustrim



12.01.2023 • 08:43



Një person ka raportuar se persona të panjohur me forcë kanë depërtuar brenda në shtëpinë e tij dhe nga aty kanë vjedhur stoli ari, pesë pistoleta, tre snajper, një pushkë gjysmë – automatike, katër pushkë gjuetie, 100 fishekë, katër palë dylbi.

Në raportin 24 orësh të Policisë së Kosovës bëhet e ditur se rasti ka ndodhur në rrugën “Behxhet Sojeva”, në Ferizaj.

Reklama

Po ashtu në raport thuhet se rasti është duke u hetuar.

“Ankuesi mashkull kosovar, ka raportuar se persona të panjohur me forcë kanë depërtuar brenda në shtëpi dhe nga aty kanë vjedhur stoli ari, pesë pistoleta, tre snajper, një pushkë gjysmë – automatike, katër pushkë gjuetie, 100 fishekë, katër palë dylbi. Rasti është duke u hetuar”, thuhet në raport.

Reklama

Sic mëson Telegrafi nga burimet e saj, pronari i shtëpisë është personi me inicialet M.J, 52 vjeçar nga Ferizaj, i cili jeton jashtë vendit.

Nga burimet e Telegrafit mësohet se pesë nga armët që i janë vjedhur në shtëpinë e tij i ka me leje.

Por, ende nuk dihet se cila është arsyeja e dhënies së lejes për zotërimin e këtyre armëve.

Ndërkaq, po ashtu Telegrafi mëson se hetuesit janë në fazën fillestare të hetimit të rastit për vjedhjen e këtyre armëve nga shtëpia e ferizajasit, dhe se personat të cilët e kanë kryer vjedhjen ende nuk janë arrestuar.

Po ashtu, Telegrafi mëson se një person tjetër e ka në mbikëqyrje shtëpinë e bashkatdhetarit ferizajas, i cili e ka raportuar rastin e vjedhjes në Policinë e Kosovës.

Reklama

Ndryshe, sipas **Nenit 11 i Ligjit për Armë** thuhet se arsyet për blerjen e armës, pjesëve të armës dhe municionit nga personi fizik, janë vetëm për armëmbajtje, gjah, shenjëtarë ose për qëllime koleksioni për të cilat lëshohet pëlqimi.

Gjithashtu në Nenin 17 të këtij ligji, llojet e lejeve për personat fizik janë këto: 1.1. leja për armëmbajtje të armës së zjarrit; 1.2. leja për armë koleksioni; 1.3. leja për armë gjahu; 1.4. leja për armë shenjëtarie; dhe 1.5. leja për armë të kategorisë D.

Po ashtu Neni 20 sqaron se nëse leja është për armë koleksioni kushtet janë këto: Leja për armë koleksioni është leje që e lejon personin fizik të posedojë koleksion të armëve sipas këtij ligji.

- Pëlqim për blerjen e armës së koleksionit i lëshohet personit fizik në bazë të kërkesës nëse i përmbush kushtet sipas nenit 7, 41 dhe 42 të këtij ligji.
- Nëse koleksioni i armëve përbëhet nga më shumë së njëzetepesë (25) armë, në bazë të kërkesave nga paragrafi 2 i këtij neni, koleksionuesi duhet t'ia bashkangjasë kërkesës deklaraten me shkrim me të cilën deklarohet se do të lejojë kontroll të papenguar të këtyre armëve nga organi kompetent dhe t'i përmbush kriteret për vendin e ruajtjes së armëve.
- Koleksionuesi të cilët i është lëshuar pëlqimi për blerjen e armës koleksioni është i obliguar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e blerjes së armës, të parashtrojë kërkesë pranë organit kompetent për regjistrimin e armës dhe për lëshimin e lejes për armë koleksioni.
- Leja nga paragrafi 4 i këtij neni lëshohet në afat vlefshmërie dhjetë (10) vite.
- Pas lëshimit të lejes së parë për koleksionimin e armëve nga paragrafi 4 i këtij neni, pëlqimi për blerjen e një arme tjetër koleksioni lëshohet nëse koleksionuesi e përmbush vetëm kushtin nga neni 7 paragrafi 1.4 i këtij ligji. /Telegrafi/

FerizajPolicia e KosovësVjedhje




Realizo dushkabina me porosi sipas dimensionit dhe modelit tuaj – mundësi unike nga Lutian Home

Sponsorizuar

Lexo më shumë

KRIZA NË UKRAINË



A po përballlet Putini me një luftë për pushtet me një ish-...



Osmani, Stefançuk: Do t'i intensifikojë komunikimet për...



Dikur aty bisedohej, festohej, qeshej e debatohej – ja si...




Ukrainasit kapin rob lufte ushtarët rusë në Bakhmut: Pse...



Gjer krijë për

Me kërkesën e lexuesve të Telegrafit rikthyem sistemin e komentimit 'Disqus'.
Rikujtim: Ju lutem të keni kujdes që në komentet tuaja të mos përdorni gjuhën e urrejtjes, ofendime apo sharje.



Start Selling Your Products via Your Own Online Store - It Could Be Cheaper than You Think

Create eCommerce Store | Search Ads | Sponsored

TaboolaFeed



Kostoja e transplantit të flokëve në Turqi mund t'ju befasojë

Transplantet e flokëve | lidhje te sponsorizuara | Sponsored



Po kërkonit para shtesë? Mund të jetë më e lehtë nga sa keni menduar

Punë nga SHëpia | Kërko reklama | Sponsored



Një femër për tri vite detyrohet të kryejë marrëdhënie seksuale nga një person në Prishtinë

Një femër ka raportuar se nga viti 2018 deri në vitin 2021 një person e ka detyruar të kryejë marrëdhënie seksuale. Në raportin 24 orësh të Policisë së Kosovës bë e ditur se rasti ka ndodhur në ...

Telegrafi

TELEGRAFI sh.p.k.

Rr. Rexhep Mala, Aktash, Nr.34, Prishtinë, Kosovë

info@telegrafi.com 038 224 093 - +383 48 222 355

Partnerët



Lajme	Stili	Radio Dukagjini	Për ne
Ekonomi	Shëndetësia	Smard	Prokurimi i hapur
Sport	Teknologji	Telegrafi Jobs	Privacy policy
Magazina	Auto	Marketing	
Femra	Fun	Arkiva	

Ky portal mirëmbahet nga kompania "Telegrafi". Materialet dhe informacionet në këtij portal nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimë, pa miratimin e drejtuesve të "Telegrafit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Na ndiqni:



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2006-2023 Portali Telegrafi